

**EU Twinning Project "Further support to the implementation of the National Qualifications Framework"
MK IPA 17 SO 01 21**

Buletini për shtator të vitit 2023

Aktivitetet në shtator të projektit Tvinnig "Mbështetje e mëtejshme për zbatimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve" financuar nga BE, MK IPA 17 SO 01 21

Projektit Twinning po i afrohet përfundimi i tremujorit ,përkushtimi dhe angazhimi që shënoi fillimin e tij vazhdoi të udhëhiqte zbatimin e tij edhe në shtator.Gjatë asaj periudhe u realizua vizita e katërtë studimore në kuadër të komponentit 2, që synon forcimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) në përputhje me Kornizën e Sigurimit të Cilësisë (SC). Në vizitën studimore që u zhvillua në Lituani prej 11 deri më 15 shtator të vitit 2023, mori pjesë delegacioni nga Maqedonia e Veriut. Ky delegacion përbëhej nga katër përfaqësues të palëve të ndryshme të përfshirë në projekt, siç është Ministria e Arsimit dhe Shkencës (më konkretisht nga Sektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sektori për Çështje Evropiane), Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" dhe Qendra për Arsim Profesional dhe Trajnim (QAPT)

Fokusi primar I kësaj vizite studimore ishte menaxhimi dhe monitorimi i KKK-së, me qëllim që të shkëmbimbejnë njohuri praktike nga kjo fushë. Për këtë, delegacioni vizitoi disa institucione të rëndësishme siç janë Qendra për Zhvillimin e Kualifikimeve dhe Arsimit Profesional dhe Trajnim (KRMRC), Universiteti i Menaxhimit dhe Ekonomisë ISM, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Sporti, Agjencia Kombëtare e Arsimit (AKA). , Qendra për trajnimin profesional në Alytus, Qendra për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SKVC), Universiteti i Vilniusit (UV) dhe Parlamenti i Lituaniës.

Programi i parashikuar për vizitën studimore filloi me diskutimin në lidhje me zhvillimin e kualifikimeve të Nivelit 5 dhe progresin dhe sfidat që lidhen me arsimin dual ,ku KRMRC-në si palë kryesore në menaxhimin e KKK-së, shërbeu si vend ideal për këtë diskutim. Më pas delegacioni vizitoi Universitetin e Menaxhimit dhe Ekonomisë ISM, ku u prezantua portofoli i programeve të Universitetit, si dhe roli i KKK - së në formulimin e programeve të studimit. Gjithashtu, grupi shprehu interes edhe për çështjet që lidhen me njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit.

Në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Sportit, delegacioni i VA u prit ngrohtësisht nga zëvendës-ministri dhe udhëheqësja e projektit nga KL, znj. Agne Kudarauskiene. Ajo prezantoi zhvillimet më të reja në sektorin e arsimin profesional dhe të lartë, duke theksuar rëndësinë e të mësuarit të përjetshëm . Më pas u bë vizitë në Agjencinë Kombëtare të Arsimit (AKK), gjatë së cilës u prezantua një pasqyrë e strukturës, funksioneve dhe aktiviteteve të ASK-së, si dhe informacion për kompjuterizimin gjithëpërfshirës të sistemit arsimor. Gjithashtu, pjesëmarrësit patën mundësinë të eksplorojnë portofolin e programeve për trajnim të Qendrës së Trajnimit Profesional në Alytus, duke marrë informacion të vlefshëm mbi zhvillimin e skemave të trajnimit dual profesional si në kompani ashtu edhe në qendrën e trajnimit të sektorit shkollor.

Vizita e delegacionit të Qendrës për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SKVC) ishte me përfitim të veçantë sepse stimuloi diskutim për menaxhimin e dokumentacionit dhe informacioneve për përmirësimin e sigurimit të cilësisë dhe njohjen e kualifikimeve. Fokusi i vizitës studimore më pas u barrtë në praktikat për sigurimin e cilësisë së Universitetit në Villnusë (VU), e përcjellur me vizitë informative në kampusin historik dhe bibliotekës, që la përshtypje pozitive tek delegacioni. Programi përfundoi me vizitë në Parlamentin e Lituaniës ku përfaqësuesit e Komisionit për Arsim dhe Shkencë prezantuan



This project is funded
by the European Union



Project contacts:
Ministry of Education and Science
Sv. Kiril i Metodij 54, 1000 Skopje
9th floor, office no.902



**EU Twinning Project "Further support to the implementation of the National Qualifications Framework"
MK IPA 17 SO 01 21**

bashkëpunimin e tyre me palët e interesuara, duke përfshirë bashkësinë akademike, përfaqësuesit e studentëve, organet qeveritare, shoqatat profesionale, përfaqësuesit e tregut të punës dhe sindikatat.



Fotografitë: Takime të organizuara në Parlamentin Lituanëz dhe në Qendrën për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SKVC)



This project is funded
by the European Union



Project contacts:
Ministry of Education and Science
Sv. Kiril i Metodij 54, 1000 Skopje
9th floor, office no.902



**EU Twinning Project "Further support to the implementation of the National Qualifications Framework"
MK IPA 17 SO 01 21**



Fotografitë: Diskutime në Agjencinë Kombëtare të Arsimit (NSA) dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Sportit

Në rrjedhë të gjysmës së dytë të shtatorit u mbajt takimi i tetë i Bordit Menaxhues të projektit Twinning. Si projekt po i afrohet fazës përfundimtare të implementimit, ky takim shërben si platformë për evaluim gjithëpërfshirës të arritjeve të projektit në kuadër të tremujorit paraprakë si dhe mundësi për shqyrtim të çdo çështje të mbetur për të cilin do të ishte nevoja për mbështetjen e projektit. Sekretarja Shtetërore, znj. Biljana Kazanxhiska, bëri pritje të ngrohtë dhe theksoi rëndësinë e veçantë të projektit gjatë arritjes së plotë të operacionalizimit të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), ngritjen e zhvillimit të sistemit kombëtar arsimor dhe avancimin e përpjekjeve të vendit për integrim në Bashkimin Evropian.



This project is funded
by the European Union



Project contacts:
Ministry of Education and Science
Sv. Kiril i Metodij 54, 1000 Skopje
9th floor, office no.902



**EU Twinning Project "Further support to the implementation of the National Qualifications Framework"
MK IPA 17 SO 01 21**

Gjatë takimit, të Znj. Jolita Butkiene, Këshilltare e Përhershme e Tving (PTS), prezantoi raportin e shtatë tremujor dhe ofroi pasqyrë të aktiviteteve të realizuara me sukses dhe rezultateve kryesore të arritura. Gjithsej 196 përfaqësues të institucioneve dhe organeve të ndryshme në Maqedoninë e Veriut morën pjesë në aktivitetet e projektit gjatë tremujorit në fjalë, përkatësisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Institucionet e arsimit të lartë (IAL), Organizata nga arsimit dhe aftësimi profesional (AFP), si dhe nga organe të tjera përkatëse. Në vazhdimësi të këtij, 18 ekspertë nga vendet anëtare ishin të angazhuar për të udhëhequr iniciativa të ndryshme të cilat rezultuan me realizim të suksesshëm të 18 ngjarjeve të projektit duke përfshirë punëtori, ngjarje për ngritjen e ndërgjegjjes dhe aktivitete/sesioneve për trajnim nga institucione të ngjashme. Ekspertët nga vendet anëtare i kushtuan gjithsej 85 ditë përgatitjes së analizave dhe rekomandimeve gjithëpërfshirëse.

Në prag të përfundimit të projektit, periudha e fundit e planifikimit parashikon 29 misione të cilat duhet t'i realizojnë ekspertë të vendeve anëtare, të sistemuara në kuadër të shtatë aktivitete të projektit. Krahas kësaj, do të organizohet edhe ngjarje për përmbylljen e projektit për të shënuar përfundimin e suksesshëm të projektit. Mbledhja e Bordit Drejtues përfundoi me miratimin formal të raportit të shtatë tremujor dhe periudhës së ardhshme të planifikimit.



Fotografitë: Takimi i tetë i Bordit Administrativ të Projektit të mbajtur më 19 shtator


Gjatë javës së fundit të shtatorit, misioni 4.1.7 u zbatua në kuadër të komponentit 4, i cili i referohet përmirësimit të interkoneksionit dhe kompatibilitetit së regjistrimit dixhital të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) si në nivel kombëtar poashtu edhe në nivel të Bashkimit Evropian. Ky mision u realizua në Shkup nga 25 deri më 29 shtator të vitit 2023. Dy ekspertë nga Sllovenia - Urshka Marentiq dhe Nejc Jensterle, mbajtën trajnime përmes të cilave kuadri do të fitonte njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për përpërdorimin dhe mirëmbajtjen e regjistrimit dixhital - si në nivelet strategjike ashtu edhe ato operative - në përputhje me qasjet relevante të aplikuara të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.



This project is funded
by the European Union



Project contacts:
Ministry of Education and Science
Sv. Kiril i Metodij 54, 1000 Skopje
9th floor, office no.902



**EU Twinning Project "Further support to the implementation of the National Qualifications Framework"
MK IPA 17 SO 01 21**

Në punëtorit që ekspertët organizuan morën pjesë përfaqësues nga Njësitë për KKK-së në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe përfaqësues nga Bordi i KKK-së dhe komisionet sektoriale. Këto iniciativa u realizuan për të motivuar kuadrin që punon me regjistrin e KKK-së, përmes shkëmbimit të njohurive të hollësishme dhe kompetencave praktike në lidhje me të kuptuarit e rolit të regjistrit të KKK-së, e cila ndikon në përmirësimin e transparencës, krahasueshmërisë dhe transferueshmërisë së kualifikimeve. Pjesëmarrësit fituan informacione të hollësishme në raport me përdorimin praktik dhe mirëmbajtjen e regjistrit të KKK-së, si dhe në lidhje me përshkrimin e kualifikimeve dhe administrimin efektiv të funksionaliteteve të tjera të regjistrit të KKK-së

Si rezultat i këtij misioni, u përgatiten edhe dy uebinarë dhe udhëzime për përdorimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit dixhital të KKK-së.



Fotografitë: Punëtoritë për përdorimin dhe mirëmbajtjen e regjistrit dixhital të KKK-së

Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja është përgjegjësi e vetme e projektit të Tvining dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian..



This project is funded
by the European Union



Project contacts:
Ministry of Education and Science
Sv. Kiril i Metodij 54, 1000 Skopje
9th floor, office no.902